



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES  
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-044, për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

**D e k r e t o j**

Ratifikimin e Marrëveshjes mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë, e nënshkruar në Prishtinë, më 9 qershor 2015, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 22 qershor 2015.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN – 014 – 2015.

Prishtinë, më 6 korrik 2015.

Atifete Jahjaga

Presidente e Republikës së Kosovës

# MARRËVESHJE

## NDËRMJET

### QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### DHE

### QEVERISË SË HUNGARISË

#### MBI

### NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE

#### PREAMBULA

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Hungarisë, këtej e tutje të referuara si "Palët";

Në aspiratat e tyre për zhvillimin dhe forcimin e e mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale në mes të dy vendeve;

Duke marrë parasysh miqësinë ekzistuese dhe bashkëpunimin ndërmjet Palëve, si dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e bashkëpunimit gjyqësor në Evropë;

Kanë rënë dakord si vijon:

#### KAPITULLI I

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Fushëveprimi i ndihmës së ndërsjellë juridike

Palët menjëherë marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike në procedurat penale lidhur me veprat penale, dënimi i të cilave, në kohën e kërkesës për ndihmë, bie brenda juridiksionit të autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese.

## Neni 2

### Kanalet dhe gjuha e komunikimit

- (1) Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, kërkesat për ndihmë juridike dorëzohen nëpërmjet Autoriteteve Qendrore të caktuara nga Palët. Autoritetet Qendrore komunikojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën në lidhje me zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Autoritetet Qendrore janë Ministria e Drejtësisë për Republikën e Kosovës, Ministri përgjegjës për Drejtësi dhe Prokurori i Përgjithshëm i Hungarisë.
- (3) Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe dokumente mbështetëse dërgohen në versionin origjinal ose kopje të vërtetuara.
- (4) Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar Republikës së Kosovës duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze, ndërsa kërkesat drejtuar Hungarisë duhet të paraqiten në gjuhën hungareze ose angleze.

## Neni 3

### Përmbajtja e kërkesës

- (1) Kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë duhet të përmbajnë si vijon:
  - a) autoritetin që parashtron kërkesën,
  - b) objektin dhe arsyen e kërkesës,
  - c) kur është e mundur, identitetin dhe kombësinë e të pandehurit dhe/ose të personit të fjalë,
  - d) kur është e nevojshme, emrin dhe adresën e personit të cilit do t'i shërbehen dokumentet.
  - e) kur është e nevojshme, informata tjera relevante rreth ekzekutimit të kërkesës, të tilla si specifikimi i ndonjë afati kohor brenda të cilit priten veprime sipas kërkesës.
- (2) Në Letër porositë e referuara në nenin 6, 7 dhe 8, përveç kësaj, duhet të ceket vepra për të cilën është duke u zhvilluar procedura penale dhe një përshkrim i fakteve.
- (3) Në rastet kur kërkohet informacion bankar, në letër porosi duhet të theksohet se informacioni bankar i ofruar sipas kërkesës do të përdoret vetëm për qëllimet e procedurës penale në lidhje me ndihmën juridike të kërkuar.
- (4) Në masën e nevojshme, në kërkesën për ndihmë të ndërsjellë juridike gjithashtu ofrohet përshkrimi i procedurës së caktuar e cila duhet ndjekur nga autoritetet e Palës së kërkuar si dhe përshkrimi i dëshmisë ose deklaratës së kërkuar nga Pala kërkuese.
- (5) Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse duhet të nënshkruhen dhe vulosen nga autoritetet kompetente të Palës kërkuese. Nuk do të kërkohet vërtetim shtesë.

## Neni 4

### Refuzimi i ndihmës së ndërsjellë juridike

(1) Kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë mund të refuzohet nga Pala e kërkuar në ndonjërin nga rastet në vijim:

a) Nëse kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë ka të bëjë me:

i. një vepër penale të cilën Pala e kërkuar e konsideron si vepër penale politike ose që ndërlihet me vepër penale politike; ose

ii. vepër penale ushtarake e cila nuk përbën vepër penale sipas ligjit penal të aplikueshëm.

b) nëse është bërë parashkrimi sipas ligjit të cilësdo Palë;

c) nëse Pala e kërkuar konsideron se ekzekutimi i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike dëmton sovranitetin apo sigurinë e saj, ose do të ishte në kundërshtim me rendin juridik dhe interesat e saj.

(2) Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe terrorizmi si dhe veprat për të cilat hetimi dhe procedurat janë të detyrueshme për Palët Kontraktuese sipas marrëveshjeve shumëpalëshe dhe ndërkombëtare, nuk do të konsiderohen vepra penale politike ose vepra penale të ndërlihdura me një vepër politike.

## Neni 5

### Veprimi mbi Kërkesat

(1) Nëse Pala e kërkuar konstaton se kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose nuk mund të ekzekutohet sipas ligjeve të saj, ajo informon menjëherë Palën kërkuese dhe i komunikon arsyet lidhur me këtë.

(2) Pas ekzekutimit të kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë, Pala e kërkuar ia kthen kërkesën origjinale Palës kërkuese së bashku me të gjitha dokumentet, informacionet apo provat e siguruara.

(3) Nëse autoriteti të cilit i drejtohet kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë nuk është kompetent për të vepruar, Pala e kërkuar i përcjellë kërkesën për ndihmë juridike të ndërsjellë autoritetit kompetent.

(4) Nëse Pala e kërkuar konstaton se informatat që gjinden në kërkesë nuk janë të mjaftueshme për të mundësuar trajtimin e kërkesës, ajo mund të kërkojë informacion shtesë.

## **KAPITULLI II LETËR POROSITË**

### **Neni 6**

#### **Letër Porositë**

Secila Palë mund t'i drejtojë letër porosi autoritetit gjyqësor të Palës tjetër me qëllim të sigurimit të dëshmive ose transmetimit të sendeve për t'u paraqitur si dëshmi, të dhëna opo dokumente.

### **Neni 7**

#### **Ekzekutimi i letër porosive**

- (1) Pala e kërkuar ekzekuton letër porosinë drejtuar asaj nga Pala kërkuese në përputhje me procedurën dhe mënyrën e parashikuar me ligjet e veta vendore.
- (2) Pala e kërkuar mund të zbatojë, sipas kërkesës, një procedurë të veçantë të kërkuar nga Pala kërkuese në ekzekutimin e Letërporosive, deri në atë masë sa një procedurë e tillë është në përputhje me ligjet e Palës së kërkuar.
- (3) Nëse Pala kërkuese dëshiron dëshmitarë ose ekspertë për të dhënë dëshmi nën betim, këtë do ta specifikoj shprehimisht në kërkesën e saj. Pala e kërkuar pajtohet me një kërkesë të tillë nëse e konsideron si të pranueshme sipas ligjit të vet vendor.
- (4) Pala e kërkuar transmeton kopjet e vërtetuara të dokumenteve dhe të dhënat e dëshmive të kërkuara, përveç nëse Pala kërkuese kërkon shprehimisht transmetimin e dokumenteve origjinale.
- (5) Zyrtarët e Palës kërkuese dhe personat tjerë të interesuar ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm, si vëzhgues, në ekzekutimin e letër porosive, nëse Pala e kërkuar pajtohet.
- (6) Nëse Pala kërkuese kërkon një gjë të tillë shprehimisht, Pala e kërkuar njofton datën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë.

### **Neni 8**

#### **Kontrolli dhe konfiskimi i pasurisë**

Pala e kërkuar ekzekuton letër porositë për kontroll ose konfiskim të pasurisë në rastet kur:

- a) vepra e cekur në letër porosi është e dënueshme me ligjin e Palës kërkuese dhe ligjin e Palës së kërkuar,
- b) ekzekutimi i letër porosive është në përputhje me ligjin e vet vendor,
- c) vepra e cekur në letër porosi përbën vepër penale të ekstradueshme për Palën e kërkuar.

## Neni 9

### **Dorëzimi dhe kthimi i pasurisë, dokumenteve dhe të dhënave**

- (1) Pala e kërkuar mund të shtyjë dorëzimin e pasurisë, dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara në qoftë se ka nevojë për pasurinë, dokumentet dhe të dhënat e cekura në ndonjë procedurë tjetër penale në pritje.
- (2) Para refuzimit ose shtyrjes së ndihmës, Pala e kërkuar mund, kur është e përshtatshme dhe pasi të jetë konsultuar me Palën kërkuese, t'i përgjigjet kërkesës pjesërisht ose t'i nënshtrohet kushteve siç i konsideron të nevojshme.
- (3) Çdo pasuri, poashtu dhe dokumentet origjinale dhe të dhënat e dorëzuara për ekzekutimin e letër porosive do të kthehen nga Pala kërkuese tek Pala e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç nëse Pala e kërkuar heq dorë nga kthimi i tyre.
- (4) Paragrafi 3 i këtij neni nuk do të dëmtoj interesat legjitime të personave me interes, duke përfshirë palët e treta *bona fides* në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të dorëzuara.

## KAPITULLI III

### **SHËRBIMI I LETËRTHIRRJEVE DHE DOKUMENTEVE GJYQËSORE, PARAQITJES SË DËSHMITARËVE, EKSPERTËVE DHE TË PANDEHURVE**

## Neni 10

### **Shërbimi i letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore**

- (1) Pala e kërkuar kryen dërgimin e letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore të cilat i përcillen asaj për këtë qëllim nga Pala kërkuese.
- (2) Dëshmia e shërbimit jepet me anë të një vërtetimi me datë dhe nënshkrim të personit të shërbyer ose me anë të një deklarate të bërë nga Pala e kërkuar që dëshmon se shërbimi është kryer duke cekur formën dhe datën e një shërbimi të tillë. Një nga këto dokumente duhet t'i dërgohet menjëherë Palës kërkuese. Nëse kërkohet nga Pala kërkuese, Pala e kërkuar thekson nëse shërbimi është kryer në përputhje me ligjin e Palës së kërkuar. Nëse shërbimi nuk mund të kryhet, atëherë Pala e kërkuar i komunikon menjëherë arsyet Palës kërkuese.
- (3) Secila Palë mban të drejtën për të shërbyer dokumente gjyqësore të shtetasve të saj në territorin e Palës së kërkuar nëpërmjet zyrtarëve të saj diplomatik ose konsullor.

## Neni 11

### **Paraqitja e dëshmitarëve, ekspertëve apo të pandehurve para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese**

- (1) Nëse Pala kërkuese e konsideron si veçanërisht të nevojshme paraqitjen personale të një dëshmitari, eksperti ose të pandehuri para autoriteteve të saj gjyqësore, ajo e specifikon këtë në kërkesën e saj për shërbimin e fletëthirrjes dhe Pala e kërkuar fton dëshmitarin, ekspertin

ose të pandehurin për tu paraqitur. Pala e kërkuar informon Palën kërkuuese lidhur me përgjigjen e dëshmitarit, ekspertit apo të pandehurit.

(2) Dëshmitari, eksperti ose i pandehuri i cili nuk iu ka përgjigjur fletëthirrjes për tu paraqitur, shërbimi i të cilit është kërkuar nga cilado Palë, nuk do t'i nënshtrohet ndonjë dënimi ose mase kufizuese në territorin e Palës së kërkuar.

(3) Në rastin e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni, kërkesa apo fletëthirrja përcakton shumën e përafërt të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe të ushqimit në përputhje me ligjin vendor të Palës kërkuuese. Nëse është parashtruar kërkesë specifike, Pala e kërkuar mund t'i ofroj paradhënie dëshmitarit, ekspertit ose të pandehurit. Paradhenia ceket në fletëthirrje dhe kompensohet nga Pala kërkuuese.

## **Neni 12**

### **Garancitë për dëshmitarë, ekspertë dhe të pandehur kur ftohen para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuuese**

(1) Dëshmitari ose eksperti, pavarësisht nga kombësia e tij/saj, i cili paraqitet me ftesë para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuuese nuk do të ndiqet penalisht, ndalohet apo t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij/saj personale në territorin e asaj Pale në lidhje me veprat ose bindjet para largimit të tij/saj nga territori i Palës së kërkuar.

(2) Personi, i cili pavarësisht shtetësisë së tij/saj, është thirrur para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuuese për t'u përgjigjur për veprat që janë objekt i procedimeve kundër tij/saj, nuk do të ndiqet penalisht, të ndalohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij/saj personale për veprat apo bindjet para largimit të tij/saj nga territori i Palës së kërkuar e të cilat nuk janë specifikuar në fletëthirrje.

(3) Imuniteti i parashikuar në këtë nen pushon kur dëshmitari, eksperti ose i pandehuri rikthehet apo mbetet në territorin e Palës së kërkuar më shumë se pesëmbëdhjetë ditë rresht prej kur prania e tij/saj nuk është e nevojshme nga autoritetet gjyqësore edhe pse ai/ajo ka pasur mundësinë të largohet nga territori;

## **Neni 13**

### **Dëgjimi përmes video-konferencës**

(1) Nëse personi gjendet në territorin e Palës tjetër dhe duhet të dëgjohet si dëshmitar apo ekspert nga autoritetet gjyqësore të Palës kërkuuese, ky i fundit mund të kërkojë që seanca të zhvillohet përmes videokonferencës. Pala kërkuuese mund gjithashtu të kërkojë dëgjimin e të pandehurit përmes videokonferencës. Përveç shkaqeve për refuzimin e ndihmës së ndërsjellë juridike të referuara në nenin 4, ndihma juridike mund të refuzohet në qoftë se:

- a) i pandehuri nuk jep pëlqimin; ose
- b) ekzekutimi i një mase të tillë për një rast të veçantë do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të ligjit të Palës së kërkuar.

(2) Aranzhimet praktike në lidhje me seancën dëgjimore do të bëhen me dakordim ndërmjet Palëve. Kur bien dakord për rregullime të tilla, Pala e kërkuar do të marrë përsipër të:

- a) ftoj dëshmitarin ose ekspertin për kohën dhe vendin e seancës ose;
- b) ftoj të pandehurin të paraqitet në seancë dëgjimore në përputhje me mënyrat e parapara nga ligji i saj vendor dhe ta informoj atë për të drejtat e tij/saj sipas ligjit të Palës kërkuese, brenda një periudhe kohore e cila do t'i mundësonte atij/asaj të ushtrojë të drejtat e tij/saj të mbrojtjes në mënyrë efektive;
- c) siguroj identifikimin e personit i cili do të dëgjohet.

(3) Në rast të zhvillimit të seancës përmes videokonferencës, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) autoriteti kompetent gjyqësor i Palës së kërkuar është i pranishëm gjatë dëgjimit, kur është e nevojshme i shoqëruar nga përkthyesi, dhe është përgjegjës për të siguruar identifikimin e personit që duhet dëgjuar dhe respektimin e parimeve themelore të ligjit të Palës së kërkuar. Nëse Pala e kërkuar është e mendimit se gjatë seancës janë duke u shkelur parimet themelore të ligjit të saj vendor, ajo menjëherë ndërmerrë masat e nevojshme për të siguruar se dëgjimi vazhdon në përputhje me parimet e lartpërmendura;
- b) kur është e nevojshme, Palët duhet të miratojnë masat për mbrojtjen e personit që duhet dëgjuar;
- c) dëgjimi zhvillohet drejtpërsëdrejti nga, ose nën drejtimin e autoritetit gjyqësor të Palës kërkuese në përputhje me ligjin e vet vendor;
- d) me kërkesë të Palës kërkuese ose të personit që duhet dëgjuar, Pala e kërkuar duhet të sigurojë që personi që duhet dëgjuar të ndihmohet nga përkthyesi nëse është e nevojshme;
- e) personi që duhet dëgjuar mund të pretendojë të drejtën për të mos dëshmuar sipas ligjit të cilësdo Palë; personi në fjalë informohet për këtë të drejtë para seancës.

(4) Pala e kërkuar, në përfundim të seancës, harton procesverbalin duke cekur datën dhe vendin e seancës, identitetin e personit që është dëgjuar, identitetin dhe funksionet e të gjithë personave të tjerë të Palës së kërkuar që marrin pjesë në seancë, çdo betim të dhënë si dhe kushtet teknike në të cilat është zhvilluar seanca. Procesverbali duhet të përcillet nga Pala e kërkuar tek Pala kërkuese.

(5) Secila palë ndërmerrë masat e nevojshme për të siguruar që legjislacioni i tij vendor zbatohet në të njëjtën mënyrë sikur seanca të zhvillohej në procedurë vendore, në rastet kur personi është duke u dëgjuar brenda territorit të saj në përputhje me këtë nen dhe refuzon të dëshmojë kur është i detyruar të dëshmojë ose nuk dëshmon të vërtetën.



## Neni 14

### **Transferimi i përkohshëm i personave në ndalim për tu paraqitur si dëshmitarë para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese**

- (1) Personi i ndaluar, paraqitja personale e të cilit bëhet me qëllim të sigurimit të provave tjera e jo për gjykim, me kërkesë të Palës kërkuese, transferohet përkohësisht në territorin e saj me kusht që ai /ajo të kthehet brenda periudhës së përcaktuar nga Pala e kërkuar.
- (2) Transferi mund të refuzohet nëse:
- a) personi i ndaluar nuk pajtohet;
  - b) prezenca e tij/saj është e domosdoshme në procedurën penale në pritje në territorin e Palës së kërkuar;
  - c) nëse transferimi rrezikon zgjatjen e ndalimit të tij/saj; ose
  - d) nëse ekzistojnë baza thelbësore për mos transferimin e tij/saj në territorin e Palës kërkuese.
- (3) Personi i transferuar mbetet në ndalim në territorin e Palës kërkuese dhe, kur është e zbatueshme, në territorin e Palës përmes së cilës është kërkuar tranziti, përveç nëse Pala e cila ka kërkuar transferimin aplikon për lirimin e tij.
- (4) Tranziti i personit në ndalim përmes territorit të cilësdo Palë, do të jepet pas aplikimit, shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme të adresuara nga Autoriteti Qendror i Palës kërkuese tek Autoriteti Qendror i Palës nëpërmjet territorit të së cilës kërkohet tranziti.
- (5) Personi i dorëzuar gëzon të drejtat e përcaktuara në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.

## **KAPITULLI IV TRANSFERIMI I PROCEDURËS PENALE**

### Neni 15

#### **Kushtet për transferimin e procedurës penale**

- (1) Nëse një shtetas i njëjës Palë, ose një person që ka një vendbanim në territorin e saj, ka kryer një vepër penale në territorin e Palës tjetër e cila është e dënueshme sipas ligjit të të dyja palëve, Pala në të cilën vepra penale është kryer mund të kërkojë nga Pala tjetër transferimin e procedurës penale.
- (2) Nëse Pala e kërkuar pranon kërkesë për transferimin e procedurës penale, autoritetet kompetente të Palës së kërkuar do ta trajtojnë procedurën penale në përputhje me ligjet vendore të asaj Pale.

## Neni 16 Përmbajtja e kërkesës

(1) Kërkesa për transferimin e procedurës penale duhet të përshkruaj faktet mbi rastin dhe të dhëna sa më të plota që është e mundur për të pandehurin, duke përfshirë shtetësinë dhe vendbanimin e tij/saj.

(2) Kërkesës do t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

- a) dokumentet origjinale të rastit ose kopjet e vërtetuara;
- b) ekstrakti i dispozitave të Kodit Penal që është aplikuar nga Pala kërkuese në atë procedurë penale.

(3) Nëse Pala e kërkuar nuk e pranon kërkesën për transferimin e procedurës penale, ajo njofton menjëherë Palën kërkuese dhe i kthen dokumentet e bashkangjitura kërkesës.

## Neni 17 Efektet e transferimit në Palën kërkuese

Autoritetet gjyqësore të Palës kërkuese heqin dorë për kohësisht nga ndjekja lidhur me veprat penale të cekura në kërkesën për transferimin e procedurës penale; nga masat e tilla heqin dorë nëse:

- a) autoriteti kompetent gjyqësor i Palës së kërkuar përfundimisht heq dorë nga ndjekja penale për shkak të mungesës së provave apo për shkak se vepra e kryer nuk përbën vepër penale,
- b) i pandehuri është liruar nga Pala e kërkuar me vendim të plotfuqishëm;
- c) vendimi i gjykatës, i cili është lëshuar nga Pala e kërkuar, veçse është ekzekutuar ose nuk ka vend për ekzekutim sipas ligjit të Palës së kërkuar;
- d) i pandehuri është falur ose amnistuar; apo
- e) ka kaluar afati i parashkrimit sipas ligjit të Palës së kërkuar.

## Neni 18 Detyrimi për të informuar

Me qëllim të dhënies së informacionit të nevojshëm autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese që përfundimisht të heqin dorë nga ndjekja penale në mënyrë që të jenë në përputhje me parimin *ne bis in diem*, Pala e kërkuar njofton Palën kërkuese me rezultatin e procedurës penale të kryer mbi bazën e një kërkesë për transferimin e procedurës penale duke transmetuar vendimin e plotëfuqishëm ose kopjen e vërtetuar.

## **KAPITULLI V DISPOZITAT E NDRYSHME**

### **Neni 19**

#### **Informatat nga regjistrat penal**

(1) Pala e kërkuar komunikon ekstrakte dhe informacion në lidhje me të dhënat gjyqësore të kërkuara nga autoritetet gjyqësore të Palës kërkuese për qëllimet e përcaktuara në paragrafin (2) a) të nenit 21, në të njëjtën masë që mund të jenë në dispozicion të autoriteteve të veta gjyqësore në një rast të ngjashëm.

(2) Në çdo rast tjetër ndryshe nga që është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, kërkesa përmbushet në përputhje me kushtet e parapara me ligjin vendor të Palës së kërkuar.

### **Neni 20**

#### **Shkëmbimi i informacionit gjyqësor**

(1) Secila palë informon Palën tjetër me të gjitha dënimet penale dhe masat e mëtejshme të shqiptuara nga autoritetet e saja gjyqësore në lidhje me shtetasit e Palës tjetër me qëllim të regjistrimit në të dhënave kriminale.

(2) Autoritetet Qendrore të të dyja palëve ia komunikojë këtë informacion njëra-tjetrës sa më shpejt që është e mundur.

### **Neni 21**

#### **Mbrojtja e të dhënave**

(1) Pa cënuar paragrafin (2) të këtij neni, të dhënat personale mund të mblidhen dhe të transmetohen vetëm nëse është e domosdoshme dhe proporcionale për qëllimet e treguara në kërkesën për ndihmë juridike.

(2) Të dhënat personale të dërguara nga njëra palë tek pala tjetër si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së përpiluar sipas kësaj Marrëveshjeje, mund të përdoren nga Pala të cilës i janë përcjellur të dhënat e tilla vetëm:

- a) për qëllime të procedurës penale për të cilat është kërkuar ndihma juridike sipas kësaj Marrëveshjeje;
- b) për procedura tjera gjyqësore dhe administrative që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me procedurat e përmendura në nënparagrafin (a);
- c) për të parandaluar një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz ndaj sigurisë publike.

(3) Të dhënat e tilla megjithatë mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër, nëse pëlqimi paraprak për këtë qëllim është dhënë nga Pala që ka transferuar të dhënat, ose nga personi i cili është subjekt i të dhënave. Pëlqimi duhet të jepet në përputhje me ligjin vendor të Palës së kërkuar.

(4) Cilado Palë mund të refuzoj përcjelljen e të dhënave personale të siguruara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së përpiluar sipas kësaj Marrëveshjeje, kur të dhënat e tilla janë të mbrojtura me legjislacionin e saj vendor.

(5) Cilado Palë që përcjell të dhëna personale të siguruara si rezultat i ekzekutimit të një kërkesë të përpiluar sipas kësaj Marrëveshjeje, mund të kërkojë nga Pala tjetër së cilës i janë përcjellur ato të dhëna, të njoftojë lidhur me mënyrën e përdorimit të të dhënave të tilla.

(6) Në përputhje me legjislacionin vendor të Palëve, subjekti i të dhënave personale do të ketë mundësi:

- a) të kërkojë informacion lidhur me përpunimin e të dhënave të tij/saj personale nga ana e autoriteteve kompetente;
- b) të kërkojë korrigjimin, fshirjen apo bllokimin e të dhënave të tij/saj personale;
- c) të shfrytëzojë mjetet ligjore nëse kërkesa e tij/saj nuk është marrë parasysh.

(7) Të dhënat personale të përcjellura sipas kësaj Marrëveshjeje përpunohen dhe fshihen në përputhje me ligjet vendore të Palës që pranon të dhënat. Pavarësisht këtyre kufizimeve të dhënat e përcjellura fshihen sapo të konsiderohet se ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë përcjellur.

(8) Ky nen nuk do të ndikojë në zotësinë e Palës së kërkuar në vendosjen e kushteve shtesë në një rast të veçantë kur kërkesa për ndihmë nuk mund të përmbushet në mungesë të kushteve të tilla. Kur kushtet shtesë vendosen në përputhje me këtë paragraf, Pala e kërkuar mund t'i kërkojë Palës kërkuese dhënien e informacionit për përdorimin të provave ose informacion shtesë.

(9) Në raster kur, pasi t'i jenë bërë të ditura Palës kërkuese, Pala e kërkuar është e vetëdijshme lidhur me rrethanat që mund t'i shkaktojë nëse kërkon një kusht shtesë në një rast të veçantë, Pala e kërkuar mund të konsultohet me Palën kërkuese për të përcaktuar shkallën në të cilën dëshmitë dhe informacionet mund të jenë të mbrojtura.

## Neni 22

### **Shpenzimet e krijuara nga ekzekutimi i kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë**

(1) Palët nuk do të kërkojnë kompenzimin e shpenzimeve si rezultat i aplikimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç në rastet kur:

- a) shpenzimet bëhen nga prania e dëshmitarëve, ekspertëve apo të pandehurve në territorin e Palës kërkuese, siç ceket në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje;
- b) shpenzimet që dalin nga transferimi i personit nën arrest sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.
- c) shpenzimet e një natyre thelbësore apo të jashtëzakonshme.
- d) shpenzimet e krijimit të videolidhjes, shpenzimet që lidhen me shërbimin e videolidhjes për Palën e kërkuar, shpenzimet për përkthyesit e ofruar, shpenzimet e krijuara nga prania e dëshmitarëve dhe ekspertëve në Palën e kërkuar do t'i kompensohen Palës së kërkuar nga Pala kërkuese, përveç nëse kjo e fundit heq dorë nga kompensimi i të gjitha ose disa prej këtyre shpenzimeve.

(2) Palët do të konsultojnë njëra tjetrën lidhur me marrëveshjen për pagesën e shpenzimeve që do të mund të kërkohen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

## **KAPITULLI VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 23 Shtrirja e efektit**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjitha kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike të dorëzuara pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

### **Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje rreth interpretimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nga Palët nëpërmjet kanaleve diplomatike.

### **Neni 25**

#### **Ndërlidhja e kësaj Marrëveshjeje me Marrëveshjet tjera ndërkombëtare**

(1) Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojnë në angazhimet e Palëve të parapara me marrëveshje tjera dypalëshe ose shumëpalëshe ndërkombëtare, apo anëtarësimin e tyre në organizata ndërkombëtare.

(2) Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në detyrimet që mund të lindin nga anëtarësimi i Hungarisë në Bashkimin Europian, rrjedhimisht dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të thirren apo interpretohen në mënyrë të tillë që të shfuqizojnë apo ndikojnë në detyrimet e Hungarisë të caktuara me Traktatet mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian.

### **Neni 26**

#### **Hyrja në fuqi, kohëzgjatja, ndryshimi dhe ndërprerja**

(1) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët kanë informuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrje në fuqi kanë përfunduar.

(2) Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

(3) Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e Palëve. Ndryshimet dhe plotësimet bëhen në protokolle të veçanta që bëhen pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje dhe hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

(4) Secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë permes dërgimit të njoftimit me shkrim Palës tjetër gjashtë muaj më parë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Përfaqësuesit e autorizuar të Palëve kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E përpiluar në Prishtinë, më 09.06.2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, serbe, hungareze, dhe angleze, me tekst të njëjtë autentik. Në rast të ndonjë ndryshimi në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës



Për Qeverinë e Hungarisë

